



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, parashtron këtë:

PROPOZIM

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 4 dhe 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e dates 28.06.2019 si dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2020 të miratojë këtë

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR FERMER

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare në shumë prej 95.000 €, për subvencionimin e fermerëve të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

1. Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi ndahet me qëllim të subvencionimit dhe furnizimit të fermerëve të Komunës së Lipjanit me serra në sipërfaqe prej 50m² dhe motokultivator si pas tabelës në vijim:

Numri i përfituesve	Çmimet
Serra në sipërfaqe prej 50 m ²	60,000 €
Motokultivator	35,000 €
Gjithsej	95.000 €

Neni 3

Procedurat e blerjes së serrave, dhe motokultivatoreve do të zhvillohen nëpërmjet procedurës së prokurimit publik

Neni 4

Mënyra e përzgjedhjes së përfituesve do të bëhet nëpërmjet shpalljes publike për aplikim në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019.

Neni 5

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2020.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës dhe Rregullores për ndarjen e subvencioneve .

Qëllimi i miratimit të këtij Propozim - Vendimi është subvencionimi dhe furnizimi i fermerëve të Komunës së Lipjanit me serra në sipërfaqe prej 50 m², dhe motokultivator.

Kryetari i Komunës në pajtim me nenet 4 dhe 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 dhe mundësitë buxhetore, për të marrë Vendim për ndarjen e mjeteve financiare kërkon nga Kuvendi i Komunës dhënien e Pëlqimit për ndarjen e shumës së propozuar në nenin 1 të këtij Propozim Vendimi .

1Nr. 400 - 4598

Lipjan, më 23.01.2020

KRYETARI KOMUNES

Imri Ahmeti

